



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:288469

Datë: 08.03.2024

Numri i dokumentit: 05426533

PPP. nr.332/23

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, gjyqtari Ibrahim Maloku, në çështjen juridike përbarimore të kreditorit Ndërmarrja Publike Banesore SH.A. me seli në Prishtinë, kundër debitorit Z.S nga Prishtina, Lagja Ulpiana, rruga “Egnatia”, Objekti A, H-I, nr.57, lidhur me çështjen përbarimore për pagim borxhi, në vlerën prej 186.00 €, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori kundër Urdhrit për lejimin e përbarimit numër P.nr.536/21, të datës 03.12.2021, të lejuar nga Zyra Përbarimore - Përbaruesi Privat Kushtrim Metaj me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 08.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET në tersi i bazuar prapësimi i debitorit Z.S nga Prishtina, ashtu që:

II. SHFUQIZOHET urdhëri përbarimor P.nr.536/21, i datës 03.12.2021 i nxjerrë nga përbaruesi privat Kushtrim Metaj në Prishtinë, anulohen të gjitha veprimet e kryera deri në këtë fazë të procedurës si dhe përfundohet procedura përbarimore e iniciuar sipas propozimit për përbarim i datës 02.12.2021.

A r s y e t i m

Zyra Përbarimore - Përbaruesi Privat Kushtrim Metaj, në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka lëshuar urdhër me të cilin ka lejuar përbarimin e borxhit, në vlerën prej 186.00 €, në bazë të faturës M2021/66478, të datës 27.10.2021, dhe e ka urdhëruar debitorën Z.S që kreditorës Ndërmarrja Publike Banesore Sh.a., t’ia paguaj borxhin, në vlerën prej 186.00 €, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore.

Kundër urdhrit për lejimin e përbarimit, brenda afatit ligjor, prapësim ka paraqitur debitorja Z.S, e cila ka theksuar se e ka kundërshtuar iniciimin e procedurës përbarimore. Ka theksuar

se fillimisht i ka kryer obligimet për shërbimet që do ti kryej kjo ndërmarrje, mirëpo e njëjta ka shkelur obligimet duke mos ofruar shërbimet e parapara me kontratë sikurse janë: instalimi i aparatit të komunikimit individual me vizitorët, në kordiorin e banesës ka më shumë se 1 vitë që nuk ka patur drita dhe vetëm këto dy javët e fundit janë aktivizuar, higjena në koridore nuk plotëson as minimumin e standardit të pranueshëm, andaj, marrë parasysh shërbimet e vogla të ofruara nga kjo ndërmarrje, ka vlerësuar se me pagesat e kryerja deri më tani, të njëjtat janë të mjaftueshme. Tutje ka shtuar se konsideron se në hyrjen e tyre ka diskriminim ngase ka shumë banorë të cilët nuk kanë lidhur kontratë dhe njëkohësisht janë shfrytëzues të atyre pak shërbimeve që ofron kjo ndërmarrje dhe bëhet fjalë për qiradhënie profitabile. Po ashtu ka theksuar se e njëjta është paguese e rregullt e shërbimeve publike që ofrohen përjashtimisht të kësaj ndërmarrje që nuk ka kryer obligimet e saja për shërbimet e zotuara me kontratë. Në fund ka theksuar se nëse nuk përmbushen detyrimet e ndërmarrjes sipas kontratës për shërbimet kërkon që kontrata të shkëputet, në të kundërtën do të procedon tutje në Gjykatë për diskriminim dhe detyrim për pagesë për shërbime që nuk ofrohen.

Kreditori në afatin e paraparë ligjor ka paraqitur përgjigje në prapësimin e debitorit. Ka theksuar se e kundërshton në tërësi prapësimin e paraqitur nga debitori, për faktin se i njëjti është pa argumente me të cilat do të vërtetohej bazueshmëria e tij. Tutje ka theksuar se debitori nuk ka ofruar prova për ta argumentuar se ekziston ndonjë nga shkaqet e parapara në nenin 71 të LPP-së, në të cilat bazohet prapësimi i palës, andaj, pretendimet e debitorit në prapësim nuk e lirojnë debitorin nga pagimi i detyrimit që rrjedhë nga kontrata e mirëmbajtjes. Po ashtu ka shtuar se me nenin 69 par.4 të LPP-së, është përcaktuar se: “Baza për praësim duhet të mbështet në prova të duhura. Provat për praësim duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi duhet refuzuar.”, andaj, në mungesë të provave, Gjykata nuk mund të pranoj prapësimin e debitorit dhe as ta ndryshoj urdhrin përmbarimor. Më tej ka shtuar se detyrimet e palëve kontraktuese janë përcaktuar me kontratën e nënshkruar në mes dy palëve, ku kreditori të gjitha shpenzimet e investimeve për rregullimin e hapësirave të përbashkëta të objektit banesor i ka kryer me mjete vetanake, kurse debitori detyrohet që t’ia paguaj shumën prej 6 Euro në muaj, vetëm sa i përket mirëmbajtjes. Andaj, si rezultat i gjithë kësaj debitori për shkak mos pagesës së borxhit sipas kontratës ka hyrë në raport detyrimor me kreditorin, dhe në prani të këtyre rrethanave e duke u nisur nga neni 245 par.1 i LMD-së: “Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori është i detyruar që ta përmbush atë me ndërjegje dhe në tërësi në përputhje me përmbajtjen e tij.”. Nga të gjitha këto arsye, ka propozuar që prapësimi i debitorit të refuzohet në tërësi, dhe urdhri për caktimin e përmbarimit të mbetet në fuqi.

Gjykata pasi që vlerësoj pretendimet e palëve në procedurë gjeti se prapësimi është i bazuar nga këto arsye:

Gjykata vlerëson se propozimi i kreditorit për përmbarim, në bazë të dokumentit të besueshëm, faturës M2021/66478, të datës 27.10.2021, është i pa bazuar sepse fatura e paraqitur nga kreditori nuk është e nënshkruar nga debitori, si dhe nuk ka prova se e njëjta i është dorëzuar debitorit, ndërsa urdhri përmbarues nga përmbaruesi privat është lëshuar vetëm në bazë të kësaj fature dhe me këtë rast lejimi i përmbarimit është bërë pa u plotësuar kushti ligjor në kuptim të

dispozitës së nenit 29 paragrafi 1 pika 1.3 dhe 40 paragrafi 1 pika 1.1, të Ligjit për Procedurën Përmbartimore, nr. 04/L-139, që nënkupton se debitori duhet ta pranoj faturën, për të plotësuar kushtin e dokumentit të besueshëm.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret është dashur që fatura ti dorëzohet debitorit dhe pastaj kjo faturë e pranuar nga ana e debitorit ti bashkëngjitet propozimit për përmbartim në mënyrë që gjykata të vlerësoj besueshmërinë e faturës dhe provave tjera të cilat i ka pasur në dispozicion. Pasi që kreditori këto veprime nuk i ka ndërmarrë, për këtë arsye gjykata e aprovoj prapësimin e debitorit dhe e anuloi urdhrin përmbartues.

Mbi bazën e të lartcekurave, gjykata gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar andaj të njëjtin vendosi që ta aprovoj në tërësi në bazë të nenit 73 paragrafi 3 i Ligjit të Procedurës Përmbartimore. Ndërsa vendosjen për anulim të veprimeve dhe përfundim të procedurës përmbartimore si në pikën II të dispozitivit, gjykata e mbështet në nenin 73 paragrafi 4 sipas Ligjit Nr.05/L-118 Për Ndryshimin Dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbartimore.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
-Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil-
PPP.nr.332/23, dt.08.03.2024

Gjyqtari,
Ibrahim Maloku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimin të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.